



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONETE PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Mënyra e zgjedhjes së programeve parashkollore nga prindërit e fëmijëve

NUMËR: 46/2007

DATË: 9.10. 2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, nenit 13.2 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim që të rregulloj mënyrën e zgjedhjes së programeve parashkollore nga prindërit e fëmijëve.

Neni 2

Zgjedhja e programeve

Prindërit kanë mundësi të zgjedhin programet parashkollore për fëmijët e tyre atëherë kur:

- a) komuna-institucioni parashkollor ka mundësi të ofroj disa programe,
- b) financuesi ofron disa programe të edukimit parashkollor, dhe
- c) prindërit kanë mundësi të paguajnë programin e caktuar parashkollor.

Neni 3

Realizimi i programeve

Edhe brenda një institucioni parashkollor mund të realizohen më shumë se një program edukativ parashkollor, nëse paraprakisht arrihet bashkëpunimi në mes komunës, institucionit parashkollor dhe prindërve të fëmijëve.

Neni 4

Miratimi

Programet parashkollore të zgjedhura nga prindërit duhet të jenë të miratuara nga MASHT-i .

Neni 5

Programet e zgjedhura

Programet parashkollore të zgjedhura nga prindërit duhet të përfshijnë elementet e parapara në Ligjin mbi Edukimin Parashkollor.

Neni 6

Procedura e zgjedhjes, deklarimi

1. Procedura e zgjedhjes së programit tjetër parashkollor bëhet me deklarinin me shkrim të prindërve për programin e caktuar parashkollor.
2. Zgjedhja e programit të caktuar parashkollor mund të bëhet edhe përmes deklarinimit të prindërve në mbledhjen e tyre.

Neni 7

Plotësimi i kushtit për zgjedhjen e programit

Prindërit mund të zgjedhin programet parashkollore për fëmijët e tyre, nëse numri i prindërve-respektivisht i fëmijëve të përcaktuar për atë program, do të jetë i mjaftueshëm për formimin e një grupi edukativ të grup-moshës së caktuar.

Neni 8**Realizimi i programit të përzgjedhur**

Drejtori i IP, pasi të ketë konstatuar se janë plotësuar kushtet sipas nenit 7 të këtij UA, duhet të fillojë me realizimin e programit të përzgjedhur, për grup-moshën e caktuar të fëmijëve parashkollor.

Neni 9**Hyrja në fuqi**

Ky UA hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Agim Veliu, ministër